



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

# PULSI PUBLIK

17

MARS 2020

*Përpiluar nga UNDP në Kosovë  
Ekipi i Projektit Pulsi Publik*

***Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve të anketës dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht as pikëpamjet e UNDP-së e as ato të USAID-it.***

# Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive .....	5
Treguesit kyç të Pulsit Publik .....	6
Drejtimi politik i Kosovës .....	7
Siguria personale .....	8
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike .....	9
Drejtimi Ekonomik.....	11
Problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova .....	12
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat .....	14
Korrupsioni në shkallë të gjerë .....	15
Qëndrimet kundrejt votimit .....	17
Mjedisi .....	18
Metodologjia .....	21
Peshimi i totaleve të popullatës .....	21
Përlllogaritja e Indekseve .....	22

## Lista e figurave

Figura 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës .....	7
Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike .....	8
Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë .....	8
Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike .....	9
Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës .....	12
Figura 6. Perceptimet për problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova .....	13
Figura 7. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik .....	14
Figura 8. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik .....	15
Figura 9. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë .....	16
Figura 10. Perceptimi i kosovarëve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë .....	17
Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë .....	17
Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë .....	18
Figura 13. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër .....	19
Figura 14. Njohuritë e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, sipas përkatësisë etnike .....	19
Figura 15. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve .....	20
Figura 16. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve, sipas përkatësisë etnike .....	21

## Lista e tabelave

Tabela 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë .....	6
Tabela 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së .....	10
Tabela 3. Analiza e trendeve të komponenteve të IBE-së .....	11
Tabela 4. Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë .....	16

## Përmbledhje Ekzekutive

Përmbledhjet e Pulsit Publik ofrojnë një pasqyrë të një numri treguesish të matur përmes anketave të Pulsit Publik të cilat i shqyrtojnë perceptimet e kosovarëve në lidhje me proceset demokratike, kushtet socio-ekonomike dhe sigurinë. Anketat e Pulsit Publik përdorin metodologji tradicionale për ta shqyrtuar situatën socio-ekonomike në Kosovë<sup>1</sup>. Përmbledhjet e Pulsit Publik i paraqesin treguesit kyç përkatës për stabilitetin politik dhe institucional, stabilitetin ekonomik dhe social, si dhe për sigurinë publike dhe personale. Së bashku, këta tregues mbërthejnë opinionin publik për çështjet kyçe politike, sociale, ekonomike, zhvillimore, si dhe për performancën e institucioneve të ndryshme në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zberthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptime dhe problemet zhvillimore me të cilat përballen grupet e ndryshme.

Rezultatet e anketës së fundit tregojnë një ulje të përgjithshme të kënaqshmërisë me punën e institucioneve kyçe në Kosovë. Këtu bën përjashtim niveli i kënaqshmërisë me punën e Presidentit, edhe pse me një rritje të papërfillshme prej 0.8% në krahasim me anketën e muajit maj 2019.

Është vërejtur edhe një rritje prej 4% e kënaqshmërisë me drejtimin aktual politik të Kosovës. Edhe pse kënaqshmëria me situatën politike renditet më lart se në anketën e mëparshme, pakënaqësia e përgjithshme mbetet mjaft e lartë, pasi 56.4% e të anketuarve raportuan se ishin të pakënaqur. Të dhënat e zberthyera sipas etnisë tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë me 10% më të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës sesa serbët e Kosovës. Rezultatet e mëtejme tregojnë një ulje të vazhdueshme të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik, e cila ra me 4.4% nga 10.4% në maj 2019 në 5.9% në nëntor 2019. Të dhënat e zberthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime në kënaqshmërinë me drejtimin ekonomik në mes të meshkujve dhe femrave. Gjithsej 6% e meshkujve dhe 5.9% e femrave janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Nga ana tjetër, ndërkohë që tek meshkujt 66.5% janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, tek femrat 60% ndihen njësoj. Të dhënat e zberthyera sipas etnisë tregojnë se serbët e Kosovës e përfaqësojnë pjesën më të lartë të të anketuarve të cilët janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës (35.7%), pasuar nga 39.1% në mes të komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe 6.2% mes shqiptarëve të Kosovës.

Indeksi i Demokratizimit (ID), i cili i ndjek opinionet e kosovarëve për proceset demokratike, ka pësuar një rritje prej 0.2 në krahasim me majin 2019. Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE), i cili i ndjek perceptimet për kushtet mbizotëruese ekonomike, ka pësuar një rritje prej 0.07 krahasuar me majin 2019. Në një shkallë prej 0 (minimumi) deri 3 (maksimumi), vlera e matur e ID-së ishte 1.23, ndërsa e IBE-së ishte 1.05.

Përqindja e kosovarëve (62.7%) të cilët besojnë se në Kosovë zgjedhjet janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare është dyfishuar nga maji i vitit 2018 (35.6%). Pjesa e të anketuarve që mendojnë se vota mund ta ndryshojë situatën është dyfishuar nga 16.8% në maj 2019 në 35.5% në nëntor 2019.

Kur u pyetën për sigurinë në rrugë, shumica e kosovarëve (73%) deklaruan se ndihen të sigurt. Të dhënat e zberthyera sipas etnisë tregojnë se shqiptarët e Kosovës (72.3%) ndihen më të sigurt në krahasim me serbët e Kosovës (27.1%). Sidoqoftë, të dhënat tregojnë rritje të vazhdueshme që nga maji 2018 kur mes serbëve të Kosovës siguria vlerësohej me 4.8%.

<sup>1</sup> Për UNDP referencat për Kosovën do të kuptohet se janë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999)

Papunësia (31.2%), korrupsioni (19.6%) dhe varfëria (10.5%) mbeten tre problemet parësore më të perceptuara. Sidoqoftë, perceptimi për papunësinë si problem parësor është ulur me 6.7%, ndërsa për korrupsionin është rritur me 3% nga anketa e majit 2019.

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 12.3% e të anketuarve thanë se dinë shumë për këtë temë, 27.3% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Vetëm 24.4% e të anketuarve thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik.

## Treguesit kyç të Pulsit Publik

Rezultatet e anketës së Pulsit Publik tregojnë një rënie të kënaqshmërisë së të anketuarve me institucionet kyçe në Kosovë, përkatësisht me ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin. Anketa e nëntorit 2019 tregon se vetëm 17.6% e të anketuarve janë të kënaqur me institucionet kyçe të kombinuara në Kosovë, çka shënon një rënie prej 4.4% nga anketa e majit 2019. Kjo e shënon nivelin më të ulët, të regjistruar ndonjëherë në Pulsin Publik, të kënaqshmërisë me institucionet qendrore në tërësi. Në shtator 2015, vlera e regjistruar ishte 18.4%.

Kënaqshmëria me punën e institucioneve qendrore në Kosovë ka përjetuar një ulje nga 17.7% në maj 2019 në 14.4% në nëntor 2019, duke e arritur nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë në Pulsin Publik. Puna e institucioneve ekzekutive të Kosovës nuk bën përjashtim nga ulja e niveleve të kënaqshmërisë. Për shembull, niveli i kënaqshmërisë me punën e Kuvendit ka rënë në 19.8% në maj 2019, në 18.6% në nëntor 2019. Niveli më i ulët është regjistruar në nëntor 2014 (16.1%). Kënaqshmëria me Kryetarin e Kuvendit ka rënë nga 23.6% në maj 2019, në 20.5% në nëntor 2019. Niveli më i ulët është regjistruar në shtator 2015 (19.8%). Po kështu, kënaqshmëria me Gjykatën ka rënë nga 18.7% në 13.6%, që është vlera më e ulët e regjistruar që nga prilli 2013 (16.7%), kurse kënaqshmëria me Prokurorinë ka rënë nga 16.4% në 14.2%, që është vlera më e ulët që nga nëntori 2010 (15.1%).

Përjashtimi i vetëm nga ulja e dëshmuar në kënaqshmërinë me punën e institucioneve të Kosovës është Presidenti, kënaqshmëria me të cilin është rritur me 0.8%, përkatësisht nga 20.4% në maj 2019 në 21.2% në nëntor 2019. Sidoqoftë, kur krahasohet me nëntorin 2018, evidentohet një ulje me 17.2 pikë përqindje.

Tabela 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

Treguesit politik		Mar-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-17	Maj-18	Nën-18	Maj-19	Nën-2019	Trend
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Qeveria	18.1%	17.3%	17.8%	20.2%	32.4%	30.0%	31.3%	17.7%	14.4%	
	Kryeministri	23.6%	14.6%	18.3%	19.7%	42.3%	33.2%	35.1%	36.5%	20.7%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.3%	19.9%	17.3%	18.9%	31.7%	32.9%	36.1%	19.6%	18.6%	
	Kryetari i Kuvendit	20.1%	19.8%	24.3%	24.9%	36.0%	31.5%	36.3%	23.6%	20.5%	
Kënaqshmëria me Presidentin	Presidenti	30.2%	30.4%	45.7%	25.5%	37.6%	39.1%	38.4%	20.4%	21.2%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	17.2%	13.9%	18.4%	22.1%	36.9%	31.2%	37.8%	18.7%	13.6%	
	Prokuroria	17.0%	12.8%	16.9%	16.3%	33.1%	29.9%	35.3%	16.4%	14.2%	


## Drejtimi politik i Kosovës

Ulja e niveleve të kënaqshmërisë me institucionet kyçe në Kosovë është reflektuar edhe në nivele të larta të pakënaqësisë me drejtimin aktual politik të Kosovës. Përkundër rritjes prej 4% të kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës nga anketa e majit 2019, shumica e të anketuarve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës (56.3%). Në përputhje me rritjen prej 4% të kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës, pakënaqësia ka rënë me 6.45%, nga 62.84% në 56.39%, respektivisht në krahasim me anketën e Majit 2019. Pothuajse një e treta e të anketuarve (33.44%) deklaruan se kanë një pikëpamje neutrale siç tregohet në Figurën 1.

Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës sesa serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës (boshnjakët e Kosovës, turqit e Kosovës, goranët e Kosovës, romët e Kosovës, egjiptasit e Kosovës dhe ashkalitë e Kosovës). Ndërkohë që 56.5% e shqiptarëve të Kosovës janë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 46.6% e serbëve të Kosovës dhe 50% e komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan të njëjtën gjë. Vetëm 10.1% e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, ndërkohë që 8.1% e serbëve të Kosovës ndihen njësoj. Përqindja e të anketuarve neutral mes shqiptarëve të Kosovës është 33%, mes serbëve të Kosovës 35.7%, dhe mes komuniteteve të tjera të Kosovës 35.1%.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më të kënaqura sesa meshkujt me drejtimin politik të Kosovës. Ndërkohë që 17.2% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 11.3% e meshkujve pohuan se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës.


Figura 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës



Vihet re edhe një ulje e gatishmërisë për të marrë pjesë në protesta politike, pasi që vetëm 31.3% e të anketuarve deklaruan se janë të gatshëm t'u bashkohen protestave politike. Kjo është një ulje prej 10.9% nga anketa e Majit 2019, kur kjo vlerë u regjistrua në 42.2%.

Përkundër rënies në gatishmërinë e të anketuarve për të protestuar, të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë se një e treta e shqiptarëve të Kosovës (32.4%) janë të gatshëm të protestojnë për shkak të situatës aktuale politike, ndërkohë që vetëm 21.1% e serbëve të Kosovës dhe 15.4% e komuniteteve të tjera të Kosovës janë të gatshëm ta bëjnë të njëjtën gjë. Ka një rritje prej 7.8 përqind mes serbëve të Kosovës që janë të gatshëm të protestojnë, si dhe një ulje prej 19.6 në mesin e komuniteteve të tjera të Kosovës, krahasuar me anketën e majit 2019.

Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike




## Siguria personale

Si tregues për sigurinë, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve (74%) ndihen të sigurt. Këto rezultate shënojnë edhe përqindjen e dytë më të lartë të sigurisë që nga Prilli 2013, kur kjo vlerë arriti 82.1%. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt ndihen më të sigurt se femrat. Ndërkohë që 76% e të anketuarve meshkuj i perceptojnë rrugët si të sigurta, 72% e femrave të anketuara mendojnë njësoj. Në krahasim me muajin Maj 2019 (67.2%), rezultatet tregojnë një rritje të numrit të meshkujve që i perceptojnë rrugët si të sigurta.

Të dhënat e zbërthyer sipas etnisë tregojnë se ekziston një dallim i madh i sigurisë së perceptuar mes komuniteteve të ndryshme. Ndërkohë që një pjesë shumë e madhe e shqiptarëve të Kosovës (72.3%) shprehën se ndihen të sigurt kur dalin në rrugë, vetëm 27.1% e serbëve të Kosovës dhe 59.4% e komuniteteve të tjera të Kosovës pohojnë të njëjtën gjë. Përkundër sigurisë së ulët të perceptuar në mesin e serbëve të Kosovës, ky numër ka treguar një rritje të vazhdueshme: 4.8% deklaruan se ndiheshin të sigurt në Maj 2018, 10.4% në Nëntor 2018, dhe 16.2% në Maj 2019.

Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë






## Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Anketa e opinionit të Pulsit Publik XVII (nëntor 2019) ka shënuar rritje pozitive si në ID ashtu edhe në IBE<sup>2</sup>, që kishin shënuar një rënie drastike në Maj 2019 nga nëntori 2018. ID-ja aktual është regjistruar në 1.23, çka shënon një rritje prej 0.2 në krahasim me majin 2019. Nga ana tjetër, IBE-ja qëndron në 1.05, çka shënon një rritje prej 0.07 në krahasim me majin 2019. Pavarësisht kësaj rritjeje, shifrat sugjerojnë se gati dy të tretat e kosovarëve kanë pikëpamje negative për proceset demokratike dhe ato ekonomike në Kosovë.

Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike



Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbërë nga një numër i komponenteve që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponente të paraqitura në Tabelën 2. Pyetjeve që bien brenda fushëveprimit të këtij indeksi mund t'u përgjigjen me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, kryesisht" ose "Po, plotësisht" në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e nëntorit 2019 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme, siç tregohet në tabelën 2.

Përqindja e kosovarëve (62.7%) të cilët besojnë se në Kosovë zgjedhjet janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare është dyfishuar nga Maji i vitit 2018 (35.6%). Shumica e kosovarëve (61.4%) konsiderojnë se Kuvendi nuk e monitoron punën e institucioneve ekzekutive qendrore, dhe vetëm 38.6% besojnë se Kuvendi i monitoron institucionet ekzekutive qendrore.

Ka një rritje të numrit të të anketuarve që konsiderojnë se gjyqësori është i pavarur në vendimet e veta. Pothuajse një e treta e të anketuarve (31.5%) konsiderojnë se gjyqësori është i pavarur në vendimet e veta, krahasuar me 21.5% që e besonin këtë në Maj 2019.

Perceptimi pozitiv se mediat e gëzojnë lirinë e shprehjes është përsëri komponenti më i vlerësuar pozitivisht i ID-së, pasi 46.7% e të anketuarve mendojnë se mediat e gëzojnë lirinë e

<sup>2</sup> ID-ja dhe IBE-ja përfaqësojnë matje të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës i sheh negativisht trendet e demokratizimit ose ato ekonomike dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës i sheh pozitivisht trendet e demokratizimit ose ato ekonomike.

shprehjes. Në krahasim me muajin Maj 2019 (32.6%), është vërejtur një rritje tek ata që besojnë se shoqëria civile shërben si një monitor i vërtetë i zhvillimeve demokratike në Kosovë, me 34.8% të të anketuarve që e pohuan këtë.

Gjithsej 29.6% dhe 24.3% e të anketuarve pohojnë se institucionet lokale përkatësisht qendrore, punojnë sipas prioriteteve të kosovarëve, krahasuar me 29.8% dhe 18.1% në Maj 2019. Ka një rritje në përgjigjet pozitive nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse ato përputhen me standardet e të drejtave të njeriut dhe nëse proceset politike në Kosovë po shkojnë në drejtimin e duhur, përkatësisht 40.3% dhe 33%, krahasuar me 33.4% dhe 22.4% të regjistruar në Maj 2019.

*Tabela 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së*

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	Mar-15	Shta-15	Pri -16	Tet-16	Tet-17	Maj -18	Nën-18	Maj -19	Nën-19	Trend
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	26.2%	23.0%	30.3%	28.0%	44.6%	50.9%	53.7%	35.6%	62.7%	
A e monitoron Kuvendi performancën e qeverisë?	21.2%	21.8%	26.6%	30.8%	36.1%	46.7%	48.3%	38.1%	38.6%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.6%	17.6%	21.0%	21.6%	31.2%	43.6%	46.0%	21.5%	31.5%	
A e gëzojnë mediat në Kosovë lirinë e shprehjes?	35.5%	46.5%	47.3%	42.3%	52.5%	52.8%	59.1%	45.6%	46.7%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	19.5%	23.1%	32.1%	30.1%	34.3%	48.3%	57.5%	32.6%	34.8%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	23.3%	27.2%	28.9%	30.4%	34.0%	50.2%	49.2%	29.8%	29.6%	
A funksionon qeverisja e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	11.8%	15.5%	18.9%	17.9%	24.7%	39.9%	37.5%	18.1%	24.2%	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	23.5%	19.8%	31.7%	31.8%	41.4%	53.4%	60.5%	33.4%	40.3%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	17.3%	15.4%	23.1%	23.8%	29.7%	46.9%	57.2%	22.4%	33.0%	

Ngjashëm me ID-në, të dhënat aktuale u krahasuan me ato të kaluarat për t'i përcaktuar luhatjet në IBE, siç tregohet në Tabelën 3. Edhe në IBE është vërejtur një rritje e ngjashme në të gjithë treguesit. Për shembull, 13.7% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve duke shënuar një rritje prej 2.1% nga Maji 2019. Gjithsej 9.1% e të anketuarve kanë vlerësim pozitiv të kushteve aktuale të biznesit në krahasim me 5.5% në Maj 2019. Vetëm 7.4% i shohin në mënyrë të favorshme kushtet aktuale të punësimit, dhe 12% kanë të njëjtën pikëpamje për kushtet e punësimit gjashtë muaj nga tani, krahasuar me 5.8% dhe 4.6% në maj 2019.

Tabela 3. Analiza e trendeve të komponenteve të IBE-së

I favorshëm	Mar-15	Shta-15	Pri -16	Tet -16	Tet -17	Maj -18	Nën-18	Maj -19	Nën-19	Trend
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot	15.1%	15.9%	23.4%	18.0%	22.4%	19.9%	18.8%	11.6%	13.7%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit	8.1%	8.3%	14.4%	13.1%	17.9%	18.5%	16.7%	5.5%	9.1%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit?	5.0%	6.8%	10.3%	7.7%	17.1%	15.4%	15.9%	5.8%	7.4%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot	6.0%	8.0%	14.0%	10.7%	18.7%	17.8%	23.3%	4.6%	12.0%	


## Drejtimi Ekonomik

Vërehet një rënie drastike në numrin e të anketuarve që janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Vetëm 5.9% e të anketuarve janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, duke shënuar një rënie prej 4.5% nga Maji 2019 dhe rënie prej 6.4% nga Nëntori 2018. Kjo kënaqshmëri është më e ulëta që nga marsi 2015, kur vetëm 5.3% e të anketuarve pretenduan se ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik. Gjithsej 30.5% e të anketuarve nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, ndërkohë që shumica e të anketuarve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur (63.47%).

Të dhënat e zbrërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime në kënaqshmërinë me drejtimin ekonomik mes meshkujve dhe femrave. Gjithsej 6% e meshkujve dhe 5.9% e femrave janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Nga ana tjetër, ndërkohë që tek meshkujt 66.5% janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, tek femrat 60% ndihen njësoj.

Të dhënat e zbrërthyer sipas etnisë tregojnë se serbët e Kosovës (35.7%) e përfaqësojnë pjesën më të lartë të të anketuarve të cilët janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, pasuar nga 39.1% mes komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe 6.2% mes shqiptarëve të Kosovës. Gjithsej 31.4% e serbëve të Kosovës, 23.5% e shqiptarëve të Kosovës dhe 20.3% e komuniteteve të tjera të Kosovës janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Vetëm 30.8% e shqiptarëve të Kosovës, 33.3% e serbëve të Kosovës dhe 22.8% e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë një mendim neutral.

Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës




## Problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova

Rezultatet e nëntorit 2019 janë të njëjta si në anketat e mëparshme: papunësia, korrupsioni dhe varfëria ende identifikohen si tre problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova. Pothuajse një e treta e të anketuarve (31.2%) e identifikuan papunësinë si çështjen madhore, e ndjekur nga korrupsioni (19.6%) dhe varfëria (10.5%). Sidoqoftë, kur krahasohen me majin 2019, pjesa e të anketuarve që e perceptojnë papunësinë si çështje madhore është ulur me 3.3%, ndërkohë që korrupsioni është rritur me 2.9% dhe varfëria me 2.5%. Gjetjet tregojnë se edhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, krimi i organizuar dhe çmimet për furnizime thelbësore konsiderohen probleme madhore, secili duke shënuar 3%.

Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë dallime ndërmjet perceptimeve të etnive të ndryshme të problemeve madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova. Ndërkohë që shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera të Kosovës i kanë renditur papunësinë, korrupsionin dhe varfërinë si tre problemet madhore, serbët e Kosovës identifikuan papunësinë (19.5%), marrëdhëniet ndëretnike (15.7%) dhe korrupsionin (10.9%) si çështjet parësore. Nga ana tjetër, komunitetet tjera të Kosovës ishin pjesa më e madhe e të anketuarve (42.6%) që e renditën papunësinë si çështjen më parësore, pasuar nga 31% e shqiptarëve të Kosovës.

Ndërkohë që si meshkujt ashtu edhe femrat i renditin këto tre çështje si parësore, për dallim nga anketa e muajit Maj 2019, të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt janë më të shqetësuar për papunësinë (35.3%) sesa femrat (27.4%). Sidoqoftë, femrat janë më të shqetësuar për korrupsionin (23.3%) sesa meshkujt (16.15%).

Figura 6. Perceptimet për problemet themelore me të cilat aktualisht përballet Kosova



## Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat


Të anketuarit u pyetën edhe për rekrutimin në baza meritore si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Gjetjet tregojnë se ka një rritje të perceptimit të punësimit në baza meritore në sektorin publik. Bazuar në gjetjet e Nëntorit 2019, 22.5% e kosovarëve besojnë se rekrutimi në sektorin publik është i drejtë, ndërkohë që në Maj 2019 kjo vlerë ishte më e ulët në 16%.

Megjithëse rezultatet tregojnë një perceptim të rritur të kosovarëve për punësimin në baza meritore në sektorin publik, kjo vlerë mbetet mjaft e ulët. Siç tregohet në Figurën 7, më shumë se dy të tretat (77.5%) e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Kjo masë shënon një rritje prej 8.7% nga anketa e muajit Nëntor 2018.

Të anketuarit i konsiderojnë këta si faktorët kryesorë për të fituar punësim në sektorin publik: besnikëritë ndaj partive (35.1%), lidhjet familjare (12.5%) dhe ryshfeti (12.5%). Nga ana tjetër, vetëm 22.4% e konsiderojnë arsimin, aftësimin profesional dhe përvojën profesionale të kombinuara si faktorë të rëndësishëm për të fituar punësim në sektorin publik. Perceptimi për besnikërinë ndaj partive si një faktor për punësimin në sektorin publik është rritur me 5% nga anketa e Majit 2019.

Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë dallime të vogla midis shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës në lidhje me punësimin në baza meritore në sektorin publik. Për shembull, 22.2% shqiptarë të Kosovës, të ndjekur nga 20% e serbëve të Kosovës dhe 18.3% e komuniteteve të tjera të Kosovës, besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm. Sidoqoftë, kur krahasohet me Majin 2019, ndërkohë që mes shqiptarëve të Kosovës është e dukshme një rritje e perceptimit në lidhje me punësimin në baza meritore në sektorin publik, e njëjta nuk vlen për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera të Kosovës. Në Maj 2019, vetëm 14.6% e shqiptarëve të Kosovës dhe 24% e të anketuarve nga komunitetet e tjera të Kosovës deklaruan se përvoja profesionale, aftësimi profesional dhe arsimimi janë faktorë të rëndësishëm për të siguruar një vend pune, dhe të njëjtën gjë e pohonin 32% e serbëve të Kosovës. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë dallime të pakta mes meshkujve (21.3%) dhe femrave (23.3%) që mendojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore.


Figura 7. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik



Ndërkohë që perceptimi i punësimit në baza meritore në sektorin privat është më i lartë sesa në sektorin publik, shumica e kosovarëve mbeten skeptikë edhe për punësimin në sektorin privat. Vetëm 33.5% besojnë se punësimi në sektorin privat përcaktohet nga faktorët e bazuar në merita. Të anketuarit besojnë se lidhjet familjare (31.9%), miqtë (16.2%) dhe, në një masë më të vogël, ryshfeti (8.3%) dhe pamja (6.3%), janë faktorë jo meritore që çojnë drejt punësimit në sektorin privat. Një përqindje më e vogël beson se përvoja profesionale (17.3%), arsimi (9.1%) dhe trajnimet profesionale (7.1%) janë faktorë të bazuar në merita për të fituar punësim në sektorin privat.

Të dhënat e zbrëthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të mëdha mes meshkujve dhe femrave në lidhje me meritokracinë në sektorin privat të Kosovës. Po kështu, të dhënat e zbrëthyera sipas etnisë nuk tregojnë dallime të mëdha midis komuniteteve të ndryshme në lidhje me faktorët e bazuar në merita që çojnë në punësim në sektorin privat.

Figura 8. Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik



## Korrupsioni në shkallë të gjerë


Mesatarisht, 34.4% e të anketuarve pohuan se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në Kosovë, dhe kjo vlerë përfaqëson një rritje prej 4.2% në nivelet e perceptimit të korrupsionit në shkallë të gjërë nga Maji 2019 (30.1%, mesatarisht), dhe rritje prej 9.1% krahasuar me muajin Nëntor 2018, siç tregohet në Tabelën 4. Institucionet që kosovarët perceptojnë se kanë korrupsion në shkallën më të madhe janë Agjencia Kosovare e Privatizimit (48.1%), Gjykatat (42%), Administrata Tatimore e Kosovës (42.2%), Doganat (41.4%), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (40.8%), dhe Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) (38.9%). Institucionet me korrupsionin më të ulët të perceptuar janë: Policia e Kosovës (20.7%), Policia e EULEX-it (23.1%) dhe organizatat ndërkombëtare (23.6%). Siç tregohet në Tabelën 4, ndërkohë që perceptimi për korrupsionin në shkallë të gjerë është rritur për të gjitha institucionet publike dhe ndërkombëtare, vetëm KEDS-i dhe institucionet qendrore kanë pasur një ulje në krahasim me muajin Maj 2019.

Tabela 4. Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

	Mar-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-17	Maj-18	Nën-18	Maj-2019	Nën-2019	Trend
<b>Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)</b>	52.6%	51.5%	37.9%	49.7%	25.5%	32.5%	25.7%	25.1%	33.4%	
<b>KEDS</b>	44.7%	35.6%	31.1%	31.4%	20.5%	33.0%	31.3%	40.7%	38.9%	
<b>Gjykatat</b>	42.9%	46.9%	42.3%	49.3%	24.9%	38.6%	29.1%	30.7%	42.0%	
<b>Doganat</b>	38.7%	41.3%	32.3%	45.2%	22.7%	39.1%	31.4%	29.3%	41.4%	
<b>Administrata qendrore/qeveria</b>	38.5%	36.0%	36.6%	49.2%	30.7%	34.7%	28.4%	36.7%	35.3%	
<b>AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)</b>	37.1%	38.3%	39.2%	45.7%	24.9%	34.5%	29.8%	40.7%	48.1%	
<b>Komunat (qeverisja lokale)</b>	33.8%	28.6%	30.0%	40.2%	25.5%	29.0%	26.4%	25.8%	29.8%	
<b>Policia e EULEX-it (CIVPOL)</b>	32.2%	35.2%	28.8%	34.1%	20.9%	29.9%	20.9%	22.5%	23.1%	
<b>Arsimi (shkollat, Universiteti)</b>	29.3%	29.0%	17.5%	31.0%	16.3%	26.2%	19.9%	20.7%	26.1%	
<b>ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)</b>	28.1%	25.0%	18.2%	32.5%	17.4%	28.9%	25.4%	35.3%	42.2%	
<b>PTK</b>	25.9%	25.2%	18.4%	29.6%	17.0%	27.8%	25.6%	44.2%	40.8%	
<b>Bankat</b>	24.3%	23.3%	23.1%	24.4%	13.1%	27.3%	26.1%	33.8%	34.1%	
<b>Organizatat ndërkombëtare</b>	20.4%	22.9%	16.0%	28.0%	10.8%	24.5%	10.7%	19.5%	23.6%	
<b>Policia e Kosovës (PK)</b>	20.4%	19.0%	13.6%	21.1%	14.9%	25.7%	21.6%	17.0%	20.7%	

Gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve e kanë formuar mendimin e tyre në lidhje me korrupsionin në shkallë të gjërë në institucionet e lartpërmendura publike dhe ndërkombëtare përmes mediave (56.4%), më shumë se një e treta përmes bisedave me të afërmit dhe miqtë (39.2%), dhe një pjesë më e vogël (4.2%) përmes përvojave personale, siç ilustron figurën 9. Është për t'u përmendur se pjesa e të anketuarve që deklaruan se kanë formuar një opinion në lidhje me korrupsionin e gjerë përmes përvojave personale, është ulur me 2.8%, nga vlera prej 7% në maj 2019.

Figura 9. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë






## Qëndrimet kundrejt votimit


Rezultatet tregojnë se qëndrimet kundrejt votimit kanë ndryshuar dukshëm. Pjesa e të anketuarve që mendojnë se vota mund ta ndryshojë situatën është dyfishuar nga 16.8% në Maj 2019 në 35.47% në Nëntor 2019. Vetëm 29.2% e të anketuarve shprehen se vota nuk mund ta ndryshojë situatën; edhe kjo vlerë është ulur me gati 20% nga anketa e Majit 2019. Vetëm 29.8% deklaruan se vota mund ta ndryshojë situatën deri në një farë mase.

Figura 10. Perceptimi i kosovarëve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se ndërkohë që 38% e meshkujve mendojnë se vota e tyre është me ndikim, vetëm 32.7% e femrave e mendojnë të njëjtën gjë. Për dallim nga 27.3% e meshkujve, pothuajse një e treta e femrave (31.2%) mendojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.


Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë se ka dallime të mëdha midis komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me perceptimin e ndikimit të votës së tyre. Ndërkohë që 37.2% e shqiptarëve të Kosovës besojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, vetëm 6.2% e serbëve të Kosovës dhe 5.4% e komuniteteve të tjera të Kosovës e besojnë të njëjtën gjë. Përqindja e serbëve të Kosovës paraqet trendin e rënies më të fortë, nga 31% në Maj 2019 dhe 61.5% në Nëntor 2018.

Përqindja më e lartë e të anketuarve që nuk mendojnë se vota e tyre është me ndikim është nga komunitetet tjera të Kosovës me 60%, pasuar nga serbët e Kosovës (34.3%) dhe shqiptarët e Kosovës (27.8%). Në mesin e të anketuarve që mendojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën deri në një farë mase, shqiptarët e Kosovës (31.3%) qëndrojnë në vlerën më të lartë, ndërkohë që vetëm 26.2% e komuniteteve tjera të Kosovës dhe 20% e serbëve të Kosovës i kanë të njëjtat perceptime.


Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



## Mjedisi


Çështjet mjedisore dhe të lidhura me mjedisin po shfaqen si shqetësime globale dhe Puls Publik e ka matur tre herë radhazi vetëdijen e publikut për nevojën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër. Gjithsej 12.8% thanë se dinë shumë për këtë temë, 33.5% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 31.5% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 22.2% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Duke parë trendet, rezultatet tregojnë se përqindja e njerëzve që pretenduan se dinin shumë rreth kësaj teme (12.8%) është rritur pak nga 10.6% në Maj 2019 dhe 7.1% në Nëntor 2018.

Figura 13. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër



Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë dallime të mprehta midis komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Shqiptarët e Kosovës (13%) renditen të parët me shumë njohuri mbi të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të ndjekur nga serbët e Kosovës (10%) dhe komunitetet tjera të Kosovës (4%). Gjithsej 27.2% e komuniteteve tjera të Kosovës, 26.7% e serbëve të Kosovës, dhe 21.5% e shqiptarëve të Kosovës, pohuan se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh midis Majit 2019 dhe Nëntorit 2019, nga 18.6% në 30% respektivisht, është vërejtur tek serbët e Kosovës që thanë se kanë pak njohuri për këtë temë.

Figura 14. Njohuritë e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, sipas përkatësisë etnike




Komunitetet tjera të Kosovës e përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri mbi këtë temë (27.2%). Kjo vlerë është rritur në mënyrë progresive nga Nëntori 2018 (12.6%) dhe Maji 2019 (25.5%).

Të anketuarit u pyetën edhe në lidhje me vetëdijesimin e tyre mbi kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Gjithsej 12.3% pohuan se janë plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 63.3% pohuan se kanë pak njohuri ose njohuri mesatare në lidhje me këto kërcënime, dhe 24.4% nuk kishin njohuri për këto kërcënime. Dallimi më i madh nga Maji 2019 (38.6%), është rënia e numrit të të anketuarve (27.3%) të cilët kanë pak njohuri për temën.


Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime domethënëse midis meshkujve dhe femrave në vetëdijen e tyre mbi kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre ose të familjeve të tyre. Gjithsej 11.8% e femrave dhe 12.6% e meshkujve pohuan se kanë shumë njohuri rreth kësaj teme.

*Figura 15. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve*



Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet mes grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit vetjak dhe të familjes. Gjithsej 23.9% e shqiptarëve të Kosovës, 27.1% e serbëve të Kosovës, dhe 23.3% e komuniteteve tjera të Kosovës, pretendojnë se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh mes Majit 2019 (40%) dhe Nëntorit 2019 (25.2%) është rënia e numrit të serbëve të Kosovës që kanë njohuri mesatare për temën. Komunitetet tjera të Kosovës (50.5%) e përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që kanë pak njohuri rreth kësaj teme, ndërkohë që shqiptarët e Kosovës (12.5%) e përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve që pretendojnë se kanë shumë njohuri rreth kësaj teme.

Figura 16. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve, sipas përkatësisë etnike



## Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje janë bazuar në një anketë të opinionit me 1,305 kosovarë mbi moshën 18 vjeçare. Në mostër janë përfshirë të dyja gjinitë, meshkuj dhe femra nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar zonat urbane dhe rurale. Konkretisht, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve tjera të Kosovës, përkatësisht turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, ashkali të Kosovës, dhe egjiptas të Kosovës. Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye në Nëntor 2019. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.

### Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë kur bëhen përlogaritjet për vlerat totale, ekipi bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e vlerave totale të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, rom të Kosovës, ashkali të Kosovës, dhe egjiptas të Kosovës): 6%.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptar i Kosovës	1,616,869	92.93
Serb i Kosovës	25,532	1.47
Turk i Kosovës	18,738	1.08
Boshnjak i Kosovës	27,533	1.58
Goran i Kosovës	10,265	0.59
Rom	8,824	0.51
Ashkali	15,436	0.89
Egjiptas	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarohen ose nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
<b>Gjithsej</b>	<b>1,739,825</b>	<b>100.00</b>

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas të Kosovës): 5%.

Megjithatë, duke pasur parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, ishte e nevojshme të shtohen edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës që janë marrë parasysh për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren parasysh këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Etni të tjera të Kosovës (turq të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, goranë të Kosovës, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas të Kosovës): 4%.

#### Përlllogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve në lidhje me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e

një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet qendrore lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga të anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërsa rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullsisë, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica e popullsisë.

